



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1700/3 prot.

Tiranë, më 12.08.2025

VENDIM

Nr. 26, datë 12.08.2025

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”), është administruar ankesa me nr. 1700 prot., datë 01.07.2025, nga znj. , me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Bashkia Tiranë” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, në cilësinë e kërkueses, nëpërmjet kërkesës për informacion datë 11.06.2025, depozituar në adresën elektronike edrejtaperinformim@tirana.al ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

1. *Dosjen e plotë tekniko – ligjore (përfshirë edhe nënshkrimet e banorëve që kanë dakordësuar) dhe genplanet e depozituara nga Brianza Dent sh.p.k;*
2. *Çdo raport, vlerësim apo opinion ekspertësh mbi projektin (verifikime teknike);*
3. *Vendimin e komisionit për pranimin e deklaratës.*

Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, ankuesi, me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ka paraqitur ankim pranë Zyrës së Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave, që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Zyra e Komisionerit ka kontaktuar me koordinatoren për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, duke kërkuar që të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Në vijim, me anë të email-it datë 03.07.2025, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke cituar se: “*... Në vijim të kërkesës suaj ardhur pranë Bashkisë Tiranë dhe protokolluar me nr. prot. R-12164, datë 12.6.2025, ju bëjmë me dije se ka përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të cilën e gjeni bashkëlidhur. Gjithashtu ju bëjmë me dije se kthim përgjigja edhe praktika shoqëruese ju është dërguar me shërbim postar ...*”.

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesja me anë të email-it datë 14.07.2025, protokolluar me nr. 1700/1, ka vijuar me ankimin duke saktësuar se: “*... Më 3 korrik 2025 mora përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (prot. A-10322/1), e cila konfirmon “pranim të deklaratës paraprake” të subjekti Brianza Dent sh.p.k. për kryerje punimesh (ashensorë, punime fasadash etj.), por nuk përfshin planarët, detajet teknike, as protokollet e banorëve pa kundërshti. Më datë 10 korrik 2025 i kam kërkuar përsëri Koordinatorës për të Drejtën e Informimit pranë Bashkisë Tiranë plotësimin e dosjes me dokumentet e mëposhtme: Planimetrinë, seksionet dhe detajet e projektit të instalimit të ashensorëve; Deklaratën paraprake të punimeve dhe protokollin e pranimin të saj; dakordësia e banorëve për mungesë kundërshtish) ...*”

Në vijim të ankimit, Zyra e Komisionerit, nëpërmjet email-it datë 17.07.2025, ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e informacionit/dokumentacionit të kërkuar, duke rivlerësuar në këtë mënyrë kërkesën për informacion brenda datës 24.07.2025.

Autoriteti Publik, nëpërmjet email-it datë 22.07.2025, ka sqaruar se: “*...Sqarojmë se dokumentacionin e plotë ja kemi vendosur në dispozicion organit kompetent të inspektimit. ... bashkëlidhur po ju dërgojmë shkresën e pranimin të deklaratës paraprake të punimeve si dhe projektin arkitektonik dhe konstruktiv të depozituar në aplikim dhe të pranuar me deklaratën paraprake. Sqarojmë se deklaratën noteriale të dakordësisë së bashkëpronarëve banorë (e cila i është vendosur në dispozicion organeve të inspektimit) nuk mund ta vendosim në dispozicion të kërkueses, pasi referuar ligjit mbrojtjen e të dhënave personale, këto deklarata përmbajnë të dhëna personale, të cilat nuk mund të vihen në dispozicion*”.

Në vijim, ankuesja, nëpërmjet email-it datë 28.07.2025, administruar me nr. 1700/2 prot. datë 29.07.2025, ka vijuar ankimin duke theksuar se: “*... Projekt-plantet janë të plotë, por deklarata noteriale e bashkëpronarëve nuk u bë e disponueshme. Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk mund të përdoret si arsytim tërësor për refuzim. Unë nuk kërkoj*

asnje të dhënë sensitive, por vetëm konfirmimin se firmëtarët janë banorë të këtij pallati, një fakt publik dhe i parashikuar nga aktet nënligjore për kuorumin e dakordësisë. Deri tani, Bashkia ka vepruar jashtë kuadrit të saj kompetencial, duke negociuar dhe dhënë leje paraprake për ndërtimin e një ashensori nga një subjekt privat/tregtar në hapësirën publike të oborrit para pallatit... Duke dhënë këtë leje pa përmbushur kuorumin e dakordësisë së banorëve, siç parashikojnë vetë rregulloret e Bashkisë, institucioni ka tejkaluar kompetencat e tij dhe ka cenuar interesin publik. ... Ju lutem të kërkonti nga Bashkia Tiranë: Disponimin e deklaratës noteriale (ose një version anonim, me të dhënat personale të të redaktuara, ose mundësi konsultimi fizik në ambientet e tyre). Konfirmimin nëse kuorumi i banorëve është përmbushur sipas aktet nënligjore ...”.

Në përfundim, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Në vijim, bazuar në pikën 2 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“informacion publik” është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”.*

Në lidhje me pretendimin e Autoritetit Publik se, mosdhënia e informacionit të kërkuar bazohet në ligjin nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Komisioneri thekson se ky refuzim nuk gjen mbështetje në ligjin e sipërpërmendur, pasi informacioni i kërkuar duhet të trajtohet në përputhje me dispozitat e LDI, si dhe është i rregulluar posaçërisht nga ligji nr. 10 112/2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, ku konkretisht në nenin 15 të tij, parashikohet se: *“1. Një kopje e vendimit për zgjedhjen e kryesisë depozitohet për regjistrim në bashki/komunë. Organet e qeverisjes vendore krijojnë regjistrin e bashkëpronësisë, i cili duhet të përmbajë emrat e anëtarëve të kryesisë dhe adresën e ndërtesës së banimit. 2. Çdo e dhënë e regjistruar dhe e publikuar në regjistrin e bashkëpronësisë, sipas dispozitave të këtij ligji, vlerësohet e njohur dhe mund t'u kundrejtohet të tretëve nga data e regjistrimit.”*

Gjithashtu, sipas nenit 16, pika 2 e ligjit të sipërcituar, parashikohet se: *“... Procesverbali i mbledhjeve dhe i vendimeve mbahet nga kryesia dhe mund të konsultohet nga secili prej bashkëpronarëve.”* duke vijuar më pas me nenin 18, pika 2, sipas të cilit: *“Vendimet e asamblesë u njoftohen të gjithë bashkëpronarëve ose përfaqësuesve të tyre të autorizuar, si dhe shpallen në një vend të dukshëm, në ndërtesë.”*, parashikim ky, i cili është në përputhje me dispozitat e LDI për sa i përket aksesit në informacion.

Duke vazhduar më tej, ligji i sipërpërmendur, në pikën 1, nenit 33, përcakton se: *“Përmirësimet e mëdha ose rinesimet e pronës së përbashkët, siç janë lyerja, mirëmbajtja e fasadës, mirëmbajtja e çatisë, vendosja e sistemeve për ujë të ngrohtë, e sistemeve të ngrohjes apo ftohjes qendrore, e depozitave të ujit, gjeneratorëve, ashensorëve dhe përmirësime të tjera të kësaj natyre, ndërmerren nga asambleja vetëm nëse miratohen nga, të paktën, 75 për qind e kuotave pjesëmarrëse.”*

Mbështetur në interpretimin e dhënë sa më sipër, deklarata e dakordësisë, bën pjesë në kategorinë e informacionit që duhet të ishte bërë publik në ambjentet e dukshme, pra është informacion me karakter publik dhe duhet të jetë i aksesueshëm për publikun. Si rrjedhojë, Autoriteti Publik, duhet të vendosë në dispozicion informacionin e kërkuar, duke mbajtur në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të LDI.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforsimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike. Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1700 prot, datë 01.07.2025, vijuar me ankimin nr.1700/1 prot., datë 14.07.2025, si dhe me nr.1700/2 prot., datë 29.07.2025 nga znj. , kundër Autoritetit Publik “Bashkia Tiranë”, me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit, sipas vijimit të ankimit nr. 1700/2 prot., datë 29.07.2025, në formatin e zotëruar, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, brenda datës 19.08.2025.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 12.08.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi